



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 90 Prot

Tirane, 03 / 01 / 2018

UDHËZIM

Nr. 01 datë 03 01 2018

MBI OPERACIONET E PRIVILEGJUARA

Mbështetur në nenin 27, 28 dhe 184, të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Në zbatim të nenit 14 deri 32, nenit 398 deri 521 dhe nenit 737, të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar; ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; të Vendimit nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Udhëzim nr. 6, datë 30.1.2015, i Ministrit të Financave “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Bazuar në pikën 1/b/i, të pjesës VIII/1, të Vendimit nr.921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar;

Me qëllim zbatimin korrekt dhe unifikues të operacioneve të privileguara;

UDHËZOJ:

I - KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Përjashtimi nga detyrimet e importit zbatohet për mallrat e deklaruara:
 - a) për herë të parë për qarkullim të lirë, ose
 - b) për qarkullim të lirë, pasi kanë qenë objekt i një regjimi tjetër doganor.
2. Për përjashtimet, të cilat i nënshtrohen plotësisht të kushteve të caktuara, kërkuesi i përjashtimit duhet t'u paraqesë autoriteteve doganore prova që vërtetojnë plotësimin e kushteve.
3. Për përjashtimet e mallrave të vendosura në qarkullim të lire, sipas një përdorimi të përcaktuar, nuk lejohet përdorimi për qëllime të tjera, pa kryer pagesën e detyrimit

të importit, përveçse kur përdorimi i ndryshëm i mallrave përputhet me kushtet për të cilat jepet përjashtimi.

4. Autoriteti kompetent për dhënien e përjashtimeve është Dega Doganore, sipas kritereve, kushteve dhe dokumentacionit të referuar në legjislacionin në fuqi dhe në pjesën II.

Për rastet e tjera të pa specifikuar në pjesën II, autoriteti kompetent për dhënien e përjashtimeve është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

5. Bazuar në nenin 45, të ligjit nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar (Kodi Doganor), kërkuesi/mbajtësi i përjashtimit, ka të drejtë të ankimojë vendimet e marra nga autoritetet doganore për refuzimin e një kërkesë apo vendimin për anulimin ose revokimin e një përjashtimi.

II. KUSHTE TË VEÇANTA

1) Misionet Diplomatike dhe Konsullore si dhe Misionet Speciale të Akredituara në Shqipëri

Baza ligjore: Shkronja "a", pika 1, neni 184, Kodi Doganor; Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, datë 18, prill 1961; Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, datë 24, prill 1963; Konventa e Nju Jorkut, datë 16, dhjetor 1969, Për Misionet Speciale; ligji nr. 9105, datë 17.07.2003, Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjencive të Specializuara"; pika 33, neni 56, ligji nr. 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; VKM 420, datë 08.06.2016 "Për miratimin e ceremonialit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë".

Përfitues: Ambasadat e akredituara në Republikën e Shqipërisë; Trupi diplomatik në rastin e dërgesave personale; Misionet speciale; Anëtarët e përfaqësive diplomatike, organizatave ndërkombëtare dhe agjencive të specializuara të OKB, mbajtës të pasaportave të shërbimit.

Procedura: E thjeshtuar (pa autorizim përjashtimi).

Objekti i përjashtimit: Mallra për përdorim nga Ambasadat e akredituara në Republikën e Shqipërisë, Trupi diplomatik, Misionet speciale.¹

Anëtarët e familjes së trupit diplomatike, që nuk janë shtetas shqiptarë, të pajisur me kartë identiteti të verdhë nga Ministria e Punëve të Jashtme (mbajtës të pasaportave të shërbimit) mund të importojnë ose të blejnë në Shqipëri pa taksa doganore, pa TVSH dhe taksa të tjera një automjet, brenda gjashtë muajve nga dita e mbërritjes së tyre në Shqipëri.

¹ Përjashtimi për zërin karburant, është në kompetencë të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Departamenti i Akcizës.

Dokumentet: Nota verbale dhe/ose kërkesa për përjashtim (në rast mallrash personale për diplomatë) dhe dokumentacioni i mallit.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37.b (DAV):

212 përjashtim nga taksat dhe TVSH^{ja} për ambasadat;
211 përjashtim nga taksat dhe TVSH^{ja} për stafin e trupit diplomatik.

2) Mallrat që importohen nga Organizatat e ndryshme të Kombeve të Bashkuara

Baza ligjore: Pika 2, neni 184, Kodi Doganor; ligji nr. 9105, datë 17.07.2003, Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjencive të Specializuara” pika 33, neni 56 dhe pika 2, neni 77, ligji nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 63, Udhëzimi nr. 6, datë 30.1.2015, i Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”; Marrëveshja ndërmjet UNDP dhe Qeverisë Shqiptare, datë 17.06.1991; Marrëveshja midis UNHCR dhe Qeverisë së Shqipërisë, datë 06.07.1994; Marrëveshja ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe UNFPA-së e datës 16.11.1996; Marrëveshja, midis Organizatës për Bujqësinë dhe Ushqimin të Kombeve të Bashkuara dhe Qeverisë Shqiptare, e datës 17 shkurt 2004; si dhe çdo marrëveshje e Qeverisë Shqiptare me organizatat e tjera të OKB^{së}.

Përfitues: Programi për Zhvillimin e Kombeve të Bashkuara (UNDP);
Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR);
Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO);
Fondi Monetar Ndërkombëtar (EMN);
Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO);
Fondacioni Ndërkombëtar i Fëmijëve në Nevojë (UNICEF);
Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencë e Kulturën (UNESCO);
si dhe çdo organizatë tjetër e OKB^{së} të vendosur në Shqipëri.

Procedura: E thjeshtuar (pa autorizim përjashtimi).

Objekti i përjashtimit: a) Mallra të cilat importohen në kuadër të projekteve të organizatave ose Agjencive të OKB, të cilat përdoren nga Institucione të Qeverisë Qëndrore apo Lokale Shqiptare;
b) Mallra për përdorim nga Organizatat ose Agjencitë e Kombeve të Bashkuara.

Dokumentet: Kërkesa për përjashtim nga Titullari i Organizatës/Agjencisë si dhe dokumentacioni i importit të mallrave.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37.b (DAV):

550 përjashtim vetëm nga taksa doganore;
551 përjashtim nga taksat dhe TVSH^{ja}.

3) Mallrat që importohen për t'u përdorur nga personalitetet e larta të shtetit

Baza ligjore: Shkronja "nj", pika 3, neni 184, Kodi Doganor; neni 489, VKM nr. 651, datë 10.11.2017, "Për dispozitat zbatuese të Kodi Doganor"; pika 11, neni 56, ligji 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Përfitues: Monarkët apo Krerët e Shteteve të tjera, ose përfaqësuesit e tyre.

Procedura: E thjeshtuar (pa autorizim përjashtimi).

Objekti i përjashtimit: Dhurata për krerët e shtetit si dhe mallrat që do të përdoren nga drejtuesit e shteteve të tjera ose përfaqësuesit e tyre gjatë një vizite zyrtare në Shqipëri.

Dokumentet: Nota verbale dhe/ose kërkesa për përjashtim si dhe dokumentacioni i mallit.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37.b (DAV):

C29 përjashtim nga taksat dhe TVSH^{ju}.

4) Mallrat e importuara nga Banka e Shqipërisë

Baza ligjore: Pika 2, neni 184, Kodi Doganor; ligji Nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"; neni 61, ligji 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Përfitues: Banka e Shqipërisë.

Procedura: Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore.

Objekti i përjashtimit: Mallra të ndryshme për përdorim nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Dokumentet: Kërkesa për përjashtim nga Banka e Shqipërisë dhe dokumentacioni i importit të mallit.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37.b (DAV):

509 përjashtim vetëm nga taksa doganore.

5) Mallrat që importohen nga individë në rastin e ndryshimit të vendqëndrimit

Baza ligjore: Shkronja "a", pika 3, neni 184, Kodi Doganor; neni 400 – 408, VKM nr. 651, datë 10.11.2017, "Për dispozitat zbatuese të Kodi Doganor", pika 3, neni 56, ligji 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Përfitues: Individ, shqiptar ose i huaj.

Procedura: Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore.

Objekti i përjashtimit: Sendet vetjake ose dhe familjare, automjetet private dhe rimorkiot, mjetet motorike dhe motoçikletat, rulotët për

kamping, barkat/jahtet private (familjare) apo për argëtim dhe mjetet ajrore private. Kodi tarifor për t'u përdorur në kutinë 33 të DAV-it është 9905 00 00.

- Dokumentet:**
- a) Aplikimi sipas Aneksit 8, Shtojca D, VKM nr. 651, datë 10.11.2017, "Për dispozitat zbatuese të Kodi Doganor";
 - b) Lista e sendeve vetjake, të cilat duhet të jenë të përdorura dhe në sasi të arsyeshme për nevojat personale apo familjare;
 - c) Dokumente që vërtetojnë lënien e rezidencës nga organi përkatës i shtetit prej nga vjen individi.¹⁾
 - ç) Leja e qëndrimit në shtetin e huaj e noterizuar, në rastin emigrantëve dhe leje qëndrimi në Shqipëri, për të huajt;
 - d) Dokumente që vërtetojnë qëndrimin e vazhdueshëm për të paktën një vit në vendin nga vjen, si p.sh: kontrata e qerasë, vërtetim nga njësi administrative, vërtetime shkollimi të fëmijëve, etj.(të paktën një nga këto dokumente) të përkthyer, në rastin emigrantëve;
 - dh) Kontrata e punësimit dhe kontrata e qerases në Shqipëri, për të huajt;
 - e) Kopje e kartës së identitetit;
 - ë) Vërtetim banimi nga njësi administrative ku do të jetojë në Shqipëri.
 - f) Në rastet kur kërkohet përjashtimi nga detyrimet doganore për "automjetet private dhe rimorkiot, mjetet motorike dhe motoçikletat, rulotët për kamping, barkat/jahtet private (familjare) apo për argëtim dhe mjetet ajrore private", përjashtimi nga detyrimet doganore jepet vetëm përkundrejt plotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 401, të VKM nr. 651, datë 10.11.2017, "Për dispozitat zbatuese të Kodi Doganor".
- Garancia çlirohet pas dy vjetësh, nëse mjeti është në pronësi të personit dhe nga të dhënat e TIMS vërtetohet se personi ka qëndruar pjesën më të madhe të kësaj periudhe në Shqipëri.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37.b (DAV):

C01 përjashtim nga taksat dhe TVSH^{ja}.

6) Mallrat që importohen nga invalidët tetraplegjik dhe paraplegjik

Baza ligjore: Pika 2, neni 184, Kodi Doganor; ligji nr. 8626, datë 22.6.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar; pika 27, neni 56, ligji nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Përfitues: Invalidët tetraplegjik ose paraplegjik.

Procedura: Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore.

Objekti i përjashtimit: Pajisje, karroca, përfshirë autovetura, deri 2500 kubikë, të përshtatura për përdorimin e tyre, në pronësi të invalidit tetraplegjik ose paraplegjik.

1) Në rastin e emigrantëve që transferohen nga Amerika dhe Kanadaja ky dokument do të zëvendësohet me të dhënat e sistemit TIMS, të cilat duhet të vërtetojnë se personi ka qëndruar jashtë shtetit për të paktën 1 vit.

Dokumentet: Kërkesa për përjashtim dhe Vërtetim nga Shërbimi Social Shtetëror dhe dokumentacioni mallrave në emër të tij.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37.b (DAV):

502 përjashtim nga taksat dhe TVSH^{ja}.

7) Mjetet e punës së deputetit

Baza ligjore: Pika 2, neni 184, Kodi Doganor; nenet 518 - 520, VKM nr. 651, datë 10.11.2017, "Për dispozitat zbatuese të Kodi Doganor", ligji nr. 8550, datë 18.11.1999, "Statusi i Deputetit", të ndryshuar.

Përfitues: Deputetët e legjislaturës në fuqi.

Procedura: Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore Tiranë.

Objekti i përjashtimit: Automjet (vetëm një automjet për legjislaturë), kompjuter, faks, telefon, projektor, fotokopje, diktofon, mobilie dhe ndriçues zyre.

Dokumentet: Kërkesa për përjashtim dhe Vërtetim nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në emër të deputetit si dhe dokumentacioni i automjetit apo mjeteve të punës.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37. b (DAV):

501 përjashtim nga taksat dhe TVSH-ja.

8) Mallrave për organizata bamirësie ose filantropike; artikuj të destinuar për të verbrit dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara

A) Mallra që importohen në kuadër ndihmash humanitare.

Baza ligjore: Shkronja "I", pika 3, neni 184, Kodi Doganor; nenet 465 - 469, VKM nr. 651, datë 10.11.2017, "Për dispozitat zbatuese të Kodi Doganor"; pika 25, 26, neni 56, ligji nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Përfitues: Institucione shtetërore, organizata bamirëse, filantropike ose fetare.

Procedura: Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore.

Objekti i përjashtimit: "Nevoja bazë" për të plotësuar nevojat elementare të qenieve njerëzore, si për shembull: ushqime, barna, veshje dhe shtresa ose mbulesa krevati, ambulanca për qendra shëndetësore si dhe zjarrfikëse për institucionet përkatëse. Kodi tarifor për t'u përdorur në kutinë 33 të DAV-it është 9919 00 00.

Dokumentet: Akt dhurimi i ndihmave, listë ngarkesa, (dokumente transporti si CMR ose B/L apo AWB), plani i shpërndarjes së ndihmave.
Për të siguruar plotësimin e kushtit që ndihmat shpërndahen falas si dhe

nuk krijojnë mundësi për abuzime ose shtrembërime të konkurrencës (pika 1, neni 465, VKM nr. 651, datë 10.11.2017, "Për dispozitat zbatuese të Kodi Doganor"), kërkesa për përjashtimin në import për ndihmat, që u shpërndahen personave në nevojë, duhet të bëhet nga institucion shtetëror, si p.sh. ministri të caktuara (apo struktura në varësi të tyre) ose pushteti lokal.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37. b (DAV):

C20 për mallra të cilat përdoren nga organizata bamirëse;
C49 për mallra të cilat përdoren nga organizata fetare;
C50 për mallra të cilat importohen nga ente publike, institucione shtetërore;
134 për mallra të cilat importohen nga OJF me status përfitimi publik.
Kodet shtesë të mësipërm janë me përjashtim nga taksat dhe TVSH^{ja}.

B) Mallra që importohen nga të verbrit dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara.

Baza ligjore: Shkronja "II", pika 3, neni 184, Kodi Doganor; nenet 470 - 477, VKM nr. 651, datë 10.11.2017, "Për dispozitat zbatuese të Kodi Doganor".

Përfitues: Të verbrit dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara.

Procedura: Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore.

Objekti i përjashtimit: Sipas Aneksit 11 dhe 12, Shtojca D, VKM nr. 651, datë 10.11.2017, "Për dispozitat zbatuese të Kodi Doganor".

Dokumentet: Kërkesa për përjashtim, librezat e noterizuar e të verbrit apo personit me aftësi të tjera të kufizuara, dokumentacioni i mallit.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37. b (DAV):

C21 përjashtim nga taksa doganore.

C) Mallra në dobi të viktimave të fatkeqësive.

Baza ligjore: Shkronja "II", pika 3, neni 184, Kodi Doganor; nenet 478 - 484, VKM nr. 651, datë 10.11.2017, "Për dispozitat zbatuese të Kodi Doganor".
Dhënia e përjashtimit duhet të jetë objekt i një Vendimi të Këshillit të Ministrave, i cili përcakton qëllimin dhe kushtet e përjashtimit.

Përfitues: Institucionet publike ose institucionet buxhetore shtetërore apo nga organizata të tjera bamirëse, filantropike ose fetare.

Procedura: Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore.

Objekti i përjashtimit: Sipas VKM për shpallje të gjendjes së emergjencës. Kodi tarifor për t'u përdorur në kutinë 33 të DAV-it është 9919 00 00.

Dokumentet: Kërkesa nga importuesi i mallit, dokumentacioni i mallit.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37. b (DAV):

C20 për mallra të cilat importohen nga organizata bamirëse;
C49 për mallra të cilat importohen nga organizata fetare;
C50 për mallra të cilat importohen nga ente publike, institucione shtetërore;

Kodet shtesë të mësipërm janë me përjashtim nga taksat dhe TVSH^{ja}.

9) Mallrat që importohen në kuadër të “Marrëveshjeve hidrokarbure”

Baza ligjore Pika 2, neni 184, Kodi Doganor; ligji nr. 7811, datë 12.04.1994 “Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 782, datë 22.2.1 994 “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim - prodhim)”, i ndryshuar; pika 39, neni 56, ligji nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përfitues: Shoqëritë hidrokarbure ose nënkontraktorët e tyre.

Procedura: Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore.

Objekti i përjashtimit: Sipas listës së mallrave të konfirmuara nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

Dokumentet: Kërkesa për përjashtim, Vërtetimi nga (AKBN) për mallrat të cilat importohen për operacionet hidrokarbure si dhe dokumentacioni i importit të mallrave.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37.b (DAV):

506 përjashtim vetëm nga taksa doganore.

517 përjashtim nga taksat dhe TVSH-ja, për fazat e kërimit të hidrokarbureve;

10) Mallra të cilat importohen nga USAID

Baza ligjore: Pika 2, neni 184, Kodi Doganor; “Marrëveshja Ekonomike bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës”, datë 10.06.1992.

Përfitues: USAID.

Procedura: Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore.

Objekti i përjashtimit: Mallra të cilat përdoren nga USAID ose nga projekte të USAID-it

Dokumentet: Kërkesa për përjashtim, Vërtetimi nga USAID dhe dokumentacioni i importit të mallrave.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37.b (DAV):

551 përjashtim nga taksat në import dhe TVSH^{ja}.

11) Mallra të cilat importohen nga Caritasi Shqiptar

Baza ligjore: Pika 2, neni 184, Kodi Doganor; ligji nr. 9865, datë 31.01.2008 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për disa çështje ekonomike dhe tatimore”.

Përfitues: Caritasi Shqiptar

Procedura: Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore

Objekti i përjashtimit: Donacionet materiale të destinuara për të realizuar misionin e

vet, përfshirë automjetet.

Dokumentet: Kërkesa për përjashtim si dhe dokumentacioni i donacioneve materiale, të destinuara për të realizuar misionin e saj.

Kodi i procedurës Shtesë Kutia 37.b (DAV):
551 përjashtim nga taksat në import dhe TVSH^{ja}.

12) Mallra të cilat importohen nga Kryqi Kuq Shqiptar

Baza ligjore: Pika 2, neni 184, Kodi Doganor; Neni 9 i ligjit Nr.7864, datë 29.09.1994 “Për Kryqin e Kuq Shqiptar”.

Përfitues: Kryqi Kuq Shqiptar

Procedura: Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore

Objekti i përjashtimit: Donacionet materiale të destinuara për të realizuar misionin e tij.

Dokumentet: Kërkesa për përjashtim si dhe dokumentacioni i donacioneve materiale.

Kodi i procedurës Shtesë Kutia 37.b (DAV):

513 përjashtim nga taksat në import dhe TVSH^{ja}.

13) Mallra që importohen nga Forcat e Armatosura dhe Policia e Shtetit

Baza ligjore Shkronja “n”, pika 3, neni 184, Kodi Doganor; shkronja “ç”, neni 486, VKM nr. 651, datë 10.11.2017, “Për dispozitat zbatuese të Kodi Doganor”.

Përfitues: Ministria e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura dhe Policia e Shtetit.

Procedura: Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore.

Objekti i përjashtimit: Në rast të Marrëveshjeve të ratifikuara nga parlamenti nuk ka kufizime përjashtimin nga taksa doganore të mallrave, mjafton që të importohen në kuadër të marrëveshjes. Nëse është importi sipas nenit 184, pika 3 (n), mallrat që përfitojnë përjashtim nga taksa doganore janë: instrumente, aparate dhe pjesët e tyre, veshmbathje, si dhe materiale logjistike, shëndetësore, makineri dhe pajisje.

Dokumentet: Kërkesa për përjashtim, akti i dhurimit për mallrat e importuara dhe dokumentacioni i importit.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37.b (DAV):

512 përjashtim vetëm nga taksat.

14) Mallra të importuara me qëllim të nxitjes së tregtisë

Baza ligjore: Shkronja “o”, pika 3, neni 184, Kodi Doganor; nenet 490 - 498, VKM nr. 651, datë 10.11.2017, “Për dispozitat zbatuese të Kodi Doganor”; pika 24, neni 56, ligji nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përfitues: Operatorët ekonomik, institucionet e ndryshme publike ose private

Procedura: Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore

Objekti i përjashtimit: Mostrat e mallrave me vlerë të papërfillshme, materialet e shtypura reklamuese, produkte që përdoren apo konsumohen në panair tregtare apo ngjarje të ngjashme.

Dokumentet: Kërkesa për përjashtim, akti i dhurimit për mallrat e importuara dhe dokumentacioni i transportit.

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37.b (DAV):

C30 përjashtim nga taksat dhe TVSH^{ja}.

15) Pjesë këmbimi të aviacionit civil

Baza ligjore: Shkronja “b”, pika 1, neni 184, Kodi Doganor; Konventa për Aviacionin Civil, Çikago datë 7 dhjetor 1944;

Përfitues: Kompani fluturimi ajror.

Procedura: E thjeshtuar (pa autorizim përjashtimi). Konfirmim nga Dega Doganore Rinas me email në adresën s_tarifa@dogana.gov.al, rast pas rasti, për importin e pjesës së këmbimit të nevojshëm.

Objekti i përjashtimit: Pjesë këmbimi për avionë, sipas kodeve tarifore të përcaktuara në Seksionin II të NKM në fuqi, paragrafi 5 i Dispozitive Speciale.

Dokumentet: Kërkesë për përjashtim, ku të jetë përcaktuar dhe kodi tarifor i pjesëve, licencë për trafik ajror të përgjithshëm, fatura e importi

Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37.b (DAV):

201 përjashtim nga taksat dhe TVSH^{ja}

16) Raste të tjera të përjashtimit nga taksa doganore dhe TVSH^{ja}

Baza ligjore: Shkronja “d”, “dh”, “ë”, “f”, “g”, “s”, “sh”, “t”, “u”, pika 3, neni 184, Kodi Doganor; pika 2, neni 420, pika 1 dhe 2, neni 439, nenet 509, 510, 511, shkronja “a”, neni 517, VKM nr. 651, datë 10.11.2017, “Për dispozitat zbatuese të Kodi Doganor”; shkronja “j”, neni 53, pika 2, 7, 8, 12, 13, 20, 21, 35 neni 56, i Ligjit Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

- 1) Dërgesat me vlerë të papërfillshme, të cilat duhet të mos kenë natyrë tregtare dhe të jenë nën vlerën ekuivalente në lekë prej 22 Euro;
- 2) Dërgesat e dërguara falas nga një individ tek një tjetër, të cilat duhet të mos kenë natyrë tregtare dhe të jenë nën vlerën ekuivalente në lekë 45 Euro;
- 3) Produktet e përfutuara nga fermerët e Republikës së Shqipërisë në prona të vendosura në vende kufitare me Republikën e Shqipërisë;
- 4) Farat, plehrat dhe produktet për trajtimin e tokës dhe të të mbjellave, të importuara nga prodhuesit bujqësorë të vendeve të tjera, për përdorim në pronat fqinje me këto vende;
- 5) Mallra që gjenden në bagazhin personal të:
 - o Udhëtarit në rrugë tokësore: nëse janë nën vlerën ekuivalente në lekë prej 300 euro për çdo udhëtar;

- Udhëtarit në rrugë ajrore ose në rrugë detare: nëse janë nën vlerën ekuivalente në lekë prej 430 euro;
 - Udhëtarit nën 15 vjeç: nëse janë nën vlerën ekuivalente në lekë prej 150 euro.
- 6) Materialet e ndryshme, për të fiksuar dhe ruajtur mallrat gjatë transportimit të tyre;
 - 7) Shtroje, foragjeret dhe ushqimet që nevojiten gjatë transportit të kafshëve;
 - 8) Karburantet dhe lubrifikantet në depozitën e mjeteve motorike tokësore, si dhe në depozita për përdorim të veçantë;
 - 9) Arkivolet, urat funerale dhe artikujt dekorativ funeral;
 - 10) Dërgesat postare për gazeta, revista dhe i librave, në rast se janë për individë.

III. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Kërkesat për përjashtim, të cilat kanë filluar dhe nuk kanë përfunduar para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, duhet të përfundojnë sipas udhëzimeve me të cilat këto procedura kanë filluar.

2. Udhëzimi nr.4, datë 03.12.2015 "Mbi Operacionet e Privileguara" me nr. Prot. 30010, datë 03.12.2015, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Belinda Ikonomi

